



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
KËSHILLI BASHKIAK**

**DEKLARATË E KRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK TË BASHKISË BELSH
MBI TRANSPARENCËN DHE TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Të nderuar qytetarë,

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Belsh e konsideron transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen qytetare si parime themelore të qeverisjes vendore dhe të ushtrimit të funksioneve të tij.

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, Këshilli Bashkiak angazhohet të garantojë publikimin e informacionit me interes publik, të sigurojë akses të barabartë për qytetarët në informacion dhe të promovojë një kulturë të hapur komunikimi me komunitetin. Programi i Transparencës është instrumenti kryesor për realizimin e këtij angazhimi. Nëpërmjet tij synojmë:

- të informojmë publikun mbi organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Këshillit Bashkiak;
- të publikojmë në mënyrë të vazhdueshme vendimet, aktet dhe dokumentet me interes publik;
- të nxisim pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe konsultimet publike;
- të forcojmë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien ndaj komunitetit.

Këshilli Bashkiak mbetet i përkushtuar për përmirësimin e vazhdueshëm të transparencës institucionale dhe mirëpret kontributin e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, medias dhe çdo grupi interesi në forcimin e qeverisjes vendore të hapur dhe demokratike.

Me bindjen se transparenca rrit besimin e qytetarëve ndaj institucioneve publike, ju siguroj se Këshilli Bashkiak do të vijojë të punojë për garantimin e së drejtës së informimit dhe për një administrim sa më të hapur e të përgjegjshëm në shërbim të komunitetit.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Kujtim DERVISHI

Belsh, 12/06/2026